



**BASHKIA KORÇË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Tombino betoni”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Tuba kanalizimesh **(44163130-0)**

**VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 2,497,468 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjet e tetë) lekë PA TVSH**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

## 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **39% e vleres te parashikuar te kontrates**.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

#### **2.4 Raport analize per cilesine e mallrave te leshuar nga nje laborator i certifikuar ne Republiken e Shqiperise.**

##### **Argumentimi:**

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *Raport analizave* është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vleresoje përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

#### **2.5 Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Sasia</b>	<b>PRONESIA</b>
Mjet Transporti (kamion me vinc)	cope 1	Në pronesi ose me qera

- a) **Per mjetin duhet te paraqitet:** dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit ( leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.
  - b) **Kur jane me qera te paraqitet:** kontrata e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronesise, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjete dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Meqënëse sasi të e mallrave objekt prokurimi janë të shumta në numër, operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion mjete me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

### Argumentimi i specifikimeve teknike

**Termet e references, sasite, specifikimet teknike janë hartuar nga personi përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr 419 Prot.date 19.09.2024.**

**Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në terren mbi gjendjen e kanaleve kulluese dhe ujëtare me qëllim përcaktimin në mënyrë të sakte të parametrave të materialeve për ofrimin e shërbimeve publike nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçe.**

**Ato janë si më poshtë:**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
<b>1</b>	Tombino O 200	ml	70
<b>2</b>	Tombino O 300	ml	115
<b>3</b>	Tombino O 400	ml	200
<b>4</b>	Tombino O 500	ml	200
<b>5</b>	Tombino O 600	ml	100
<b>6</b>	Tombino O 800	ml	50
<b>7</b>	Tombino O 1000	ml	86
<b>8</b>	Tombino O 1200	ml	10
<b>9</b>	Tombino O 1500	ml	5

### Specifikimi i Materialeve:

- 1.Tubo beton (Tombino) të jenë me hekur dhe sipas standarteve teknike të miratuara.
- 2.Tubot që kanë diametër 300 mm, 600 mm, 800 mm dhe 1000 mm ose 30cm, 60 cm, 80cm dhe 100 cm të jenë të gjitha me patente .
- 3.Gjatesia 110 cm
- 4.Trashesia për tubot deri në 1000 mm të jetë me pak se 10 cm
- 5.Trashesia për tubot deri në 1200 mm të jetë me pak se 14 cm
6. Fortesia (Marka) të jetë  $\geq 250$ .

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**Kjo kontrate ka për qëllim realizimin e furnizimit me Tombino betoni.**

**Kontraktuesi duhet të furnizojë mallrat, objektin i prokurimit në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e percaktuar që është magazina e ndermarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë jo më vonë se 48 orë nga marrja e kërkesës.**

### Afati

**12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes kuader.**

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndermarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit. Materialet janë specifikuar në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për të qenë sa më rezistente dhe të dukshme në rrugë, gjithashtu që do të përmbushin të gjitha standartet.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipin ose origjinën apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**